



MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA E KURRIKULËS DHE E KUALIFIKIMIT

MODELE TESTESH PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

(Detyra përmbledhëse të hartuara nga mësuesit)

LËNDA “Art pamor”



TETOR, 2019

Mësuesi: Eni Larushku

KLASA: 5 –të

SHKOLLA: Skënder Çaçi

QYTETI: Tiranë

LËNDA: Art pamor

Ky shembull i detyrës përmbledhëse, është realizuar duke u mbështetur në njohuritë e përzgjedhura nga një tematikë e lëndës “Art pamor” gjatë periudhës (Janar-Mars).

Në këtë shembull detyra përmbledhëse është: Konstruksioni, materialet e riciklueshme.

DETYRA PËRMBLEDHËSE – Periudha(JANAR-MARS)			
	Tematikat e lëndës	Rezultatet e të nxënit	Përqindjet %
I	Teknika dhe procese	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">- përdor forma të ndryshme natyrale ose gjeometrike, për të krijuar;- krijon një ndërtesë imagjinare ose një objekt, duke përdorur shumëllojshmëri hapësirash për një strukturë komplekse;- mbështetet për punën e tij në vepra arti, artizanati, objekte të trashëgimisë kulturore, dizajni dhe arkitekture nga vende, kohë dhe stile të ndryshme.	100%
TEMA E DETYRËS : Konstruksioni - materialet e riciklueshme			
	<i>Për zhvillimin e kësaj detyre përmbledhëse mësuesit duhet të realizojnë hapat e mëposhtme.</i>		

II	<p>Hapi 1:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bisedë e zhvilluar lidhur me materialet që nxënësit duhet të përzgjedhin për detyrën “Konstruksioni me materiale të riciklueshme” - Ndarja e grupeve (me nga katër nxënës). - Zgjedhja e hapësirëva të jashtme (<i>lulishte me gjelbërim, kënd lojërash për fëmijë, fushë sportive, vendbanim me ndërtesa të vjetra</i>). (25–38 %) <p>Hapi 2:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndarja e detyrave brenda grupit detyrave/roleve. - Maketi - mbi një karton të qëndrueshëm, me përmasa 80 x 60, i cili është edhe maketi i hapësirës ku do të punohet dhe ku mbi të do të vendosen të gjithë objektet e krijuara nga secili grup me materialet e riciklueshme. (39-51 %) - Objekti duhet të realizohet nga çdo pjesëtar i grupit, të cilët këshillohen të vënë në përdorim sa më shumë materiale. (52 -64 %) - Fillon ngjitja e objekteve në miniaturë dhe shpërndarja së tyre mbi karton, pas projektimit. (65-77%) <p>Hapi 3:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përfaqësuesi i grupit prezanton punën e realizuar nga grupi i tij. (78 -90%) - Diskutime, vlerësime dhe sugjerime pas prezantimit, nga nxënësit e grupeve të tjera, lidhur me <i>për përzgjedhjen e hapësirës, paqartësitë, vështirësitë e hasura etj.</i>. (91 –100 %)
N 2	<ul style="list-style-type: none"> - Identifikon forma të ndryshme natyrale ose gjeometrike. - Paraqet ndërtesë imagjinare ose një objekt, duke përdorur shumëllojshmëri hapësirash për një strukturë komplekse. - Vëzhgon i orientuar për punën e tij në vepra arti, artizanati, objekte të trashëgimisë kulturore, dizajni dhe arkitekture nga vende, kohë dhe stile të ndryshme.
	<ul style="list-style-type: none"> - Paraqet forma të ndryshme natyrale ose gjeometrike.

III	N 3	<ul style="list-style-type: none"> - Përdor një ndërtesë imagjinare ose një objekt, duke përdorur shumëllojshmëri hapësirash për një strukturë komplekse. - Vëzhgon dhe mbështetet për punën e tij në vepra arti, artizanati, objekte të trashëgimisë kulturore, dizajnit dhe arkitekturës, nga vende, kohë dhe stile të ndryshme. 					
	N 4	<ul style="list-style-type: none"> - Përdor forma të ndryshme natyrore ose gjeometrike, për të krijuar. - Krijon një ndërtesë imagjinare ose një objekt, duke përdorur shumëllojshmëri hapësirash për një strukturë komplekse. - Argumenton me një gjuhë të qartë punën e tij të mbështetur në vepra arti, artizanati, objekte të trashëgimisë kulturore, dizajni dhe arkitekture nga vende, kohë dhe stile të ndryshme. 					
Skema e vlerësimit							
Nota	4	5	6	7	8	9	10
% e pikëve	< 25 %	25–38 %	39-51 %	52 -64 %	65-77%	78 -90%	91 –100 %

Mësuesi: Silva Maranaku

KLASA: 6 –të

SHKOLLA: Dëshmorët e Lirisë

QYTETI: Tiranë

LËNDA: Art pamor

Ky shembull i detyrës përmbledhëse, është realizuar duke u mbështetur në njohuritë e përzgjedhura nga një prej tematikave “Historia, arti dhe shoqëria”, të lëndës “Art pamor” gjatë periudhës III, (Prill-Qershor).

Në këtë shembull detyra përmbledhëse është: *Ekspozita e fundvitit*

DETYRA PËRMBLEDHËSE – PERIUDHA III (PRILL-QERSHOR)			
	Tematikat e lëndës	Rezultatet e të nxënit	Përqindjet %
I	<i>Historia, arti dhe shoqëria</i>	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• vlerëson elementët e gjuhës vizuale, teknikën, gjininë në një veprë arti dhe vlerëson veprat e artit në aspektin e tyre historik;• përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar, komentuar dhe vlerësuar veprat e artit dhe eksperiencën e tij/saj artistike;• vlerëson rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri dhe bashkëvepron me të tjerët për ndarjen e punës.	100%
TEMA E DETYRËS: Ekspozita e fundvitit			
Metodologjia e zhvillimit të DP			
	<i>Për zhvillimin e kësaj detyre përmbledhëse mësuesit duhet të realizojnë hapat e mëposhtme.</i>		
	Hapi 1: <ul style="list-style-type: none">- Ndarja e nxënësve në tri skuadra ku secila prej tyre përzgjedh punimet që ka krijuar gjatë periudhave të ndryshme.		

II	<ul style="list-style-type: none"> - Diskutimi i tri skuadrave mbi tematikat me të cilat do të përfaqësohen dhe mënyrën e ekspozimit të punëve të përzgjedhura. (25 – 38 %) - Krijimi i një mjedisi pozitiv, bashkëpunues pune të përbashkët, si çelës i organizimit të një ekspozite të mirë. (39-51 %) <p>Hapi 2:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diskutimi dhe përcaktimi i hapësirave të tyre për ekspozim. - Vendosja e punimeve në tabakë kartoni dhe diskutime rreth prezantimi të tyre, duke përfruar tematikë e përodur me figura të njohura të artit. (52 - 64 %) - Ekspozimi i punimeve të vendosura në tabakë, në muret e klasës. - Sugjerime, vlerësime dhe përmirësime të vendosjes së punimeve sipas tematikave që ato përfaqësojnë. (65 -77%) <p>Hapi 3:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diskutimi dhe prezantimi mbi punimet artistike dhe mënyrën e tyre të realizimit sipas teknikave artistike të përdorura dhe historikun e zhvillimit të teknikave. (78 - 90 %) - Vlerësimi, duke vendosur dy yje dhe një dëshirë për secilin punim, duke argumentuar ato. (91 – 100 %) 						
	Vlerësimi i DP						
III	N 2	<ul style="list-style-type: none"> - identifikon elementët e gjuhës vizuale, teknikën, gjininë në një vepër arti dhe identifikon vepra arti nga periudha të ndryshme historike; - përdor një gjuhë specifike të thjeshtë për të përshkruar veprat e artit dhe eksperiencën e tij/saj artistike; - evidenton rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri dhe bashkëvepron me të tjerët për ndarjen e punës; 					
	N 3	<ul style="list-style-type: none"> - shpjegon elementët e gjuhës vizuale, teknikën, gjininë në një vepër arti dhe shpjegon veprat e artit në aspektin e tyre historik; - përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar dhe komentuar veprat e artit dhe eksperiencën e tij/saj artistike; - shpjegon rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri dhe diskuton/bashkëvepron me të tjerët për ndarjen e punës; 					
	N 4	<ul style="list-style-type: none"> - vlerëson elementët e gjuhës vizuale, teknikën, gjininë në një vepër arti dhe vlerëson veprat e artit në aspektin e tyre historik; - përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar, komentuar dhe vlerësuar veprat e artit dhe eksperiencën e tij/saj artistike; - vlerëson rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri dhe diskuton/bashkëvepron me të tjerët për ndarjen e punës. 					
Skema e vlerësimit							
Nota	4	5	6	7	8	9	10

% e pikëve	< 25 %	25 – 38 %	39-51 %	52 -64 %	65 -77%	78 -90 %	91 – 100 %	
------------	--------	-----------	---------	----------	---------	----------	------------	--

Mësuesi: Silva Maranaku

KLASA: 7 –të

SHKOLLA: Dëshmorët e Lirisë

QYTETI: Tiranë

LËNDA: Art pamor

Detyrë përmbledhëse e mbështetur në njohuritë e përzgjedhura nga tri tematikat e lëndës të periudhës së II (Janar-Mars).

Tri tematikat e lëndës dhe njohuritë e përfshira në planifikimin e periudhës janë:

- Tematika **Gjuha dhe komunikimi**: vijat, ngjyrat, format, motivi, ritmi, baraspesha, kontrasti.
- Tematika **Teknika dhe procese**: piktura, stampimi, kolazhi.
- Tematika **Historia, arti dhe shoqëria**: vlerësimi i rolit të revistës dhe të dizajnit grafik.

Në këtë shembull detyra përmbledhëse është: Krijimi i revistës.

DETYRA PËRMBLEDHËSE – Periudha II (Janar-mars)			
	Tematikat e lëndës	Rezultatet e të nxënit	Përqindjet %
I	<i>Gjuha dhe komunikimi</i>	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• përdor elementet e artit dhe mënyra të larmishme të kombinimit të tyre, për të realizuar idetë duke u mbështetur te eksperiencia, vëzhgimi dhe imagjinata, në mënyrë individuale por edhe në grup;	50 %
	<i>Teknika dhe procese</i>	<ul style="list-style-type: none">• përdor mundësitë e shumta shprehëse të teknikave të ndryshme artistike në lidhje me mesazhin që do të përcjellë;	30 %
	<i>Historia, arti dhe shoqëria</i>	<ul style="list-style-type: none">• përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar, komentuar dhe vlerësuar veprat e artit të dizajnit të përdorimit të përditshëm në përshtatje me njohuritë dhe konceptet që përmban programi.	20 %
TEMA E DETYRËS: Krijimi i revistës			
Metodologjia e zhvillimit të DP			

<p>Për zhvillimin e kësaj detyre përmbledhëse mësuesit duhet të realizojnë hapat e mëposhtme.</p>		
II	<p>Hapi 1:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndarja e klasës në grupe. - Përzgjedhja e burimeve të ndryshme për mbledhjen e informacionit. - Sjellja në klasë e revistave të ndryshme dhe diskutimi midis grupeve mbi rolin, funksionin dhe qëllimin e tyre. - Përzgjedhja e titullit të revistës, për të cilën ata do të punojnë (<i>revistë sportive, modë, arti dhe shoqëria etj.</i>). (25–38 %) 	
	<p>Hapi 2:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përzgjidhet informacioni nga secili grup për mesazhin që do të përcjellë përmes punimit artistik /revistës. (39-51 %) - Përzgjidhen teknikat që ata duan për të punuar si: (<i>lapsa me ngjyra, akuarele, kolazhin, stampimin</i>). (52 -64 %) - Kombinohen materiale me tekst dhe me fotografi gjatë punës, të cilat janë elemente shumë të rëndësishme në kombinimin e tyre (dizajni grafik). (65-77%) 	
	<p>Hapi 3:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ekspozohen punimet në klasë. - Prezantojnë punën e tyre, duke shpjeguar funksionin e revistës, teknikën e përdorur për realizimit të saj, nga cili artist janë përdorur teknika e përzgjedhur. (78 -90%) - Argumentojnë rolin e dizajnit si kërkesë e kohës dhe rëndësinë e tij, në informim, sensibilizim dhe promovim. (91 –100 %) 	
Vlerësimi i DP		
III	N 2	<ul style="list-style-type: none"> - përdor elementet e artit dhe teknikat artistike duke ndjekur modele të njohura për të realizuar idetë artistike duke u mbështetur te eksperiencia, vëzhgimi dhe imagjinata, në mënyrë individuale por edhe në grup; - përdor teknika të ndryshme tradicionale duke ndjekur skema te gatshme në lidhje me mesazhin që do të përcjellë; - përdor një gjuhë specifike të thjeshtë për të përshkruar veprat e artit të dizajnit, të përdorimit të përditshëm në përshtatje me njohuritë dhe konceptet që përmban programi;
	N 3	<ul style="list-style-type: none"> - përdor elementet e artit dhe disa mënyra të kombinimit të tyre për të realizuar idetë artistike duke u mbështetur te eksperiencia, vëzhgimi dhe imagjinata, në mënyrë individuale por edhe në grup; - përdor mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike në lidhje me mesazhin që do të përcjellë; - përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar, komentuar veprat e artit, të dizajnit, të përdorimit të përditshëm në përshtatje me njohuritë dhe konceptet që përmban programi;
		<ul style="list-style-type: none"> - përdor elementet e artit dhe mënyra të larmishme të kombinimit të tyre për të

	N 4	<p>realizuar idetë duke u mbështetur te eksperiencia, vëzhgimi dhe imagjinata, në mënyrë individuale por edhe në grup;</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor mundësitë e shumta shprehëse të teknikave të ndryshme artistike në lidhje me mesazhin që do të përcjellë; - përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar, komentuar dhe vlerësuar veprat e artit të dizajnit të përdorimit të përditshëm në përshtatje me njohuritë dhe konceptet që përmban programi. 					
Skema e vlerësimit							
Nota	4	5	6	7	8	9	10
% e pikëve	< 25 %	25–38 %	39-51 %	52 -64 %	65-77%	78 -90%	91 –100 %

Mësuesi: Silva Maranaku

KLASA: 9 –të

SHKOLLA: Dëshmorët e Lirisë

QYTETI: Tiranë

LËNDA: Art pamor

Detyrë përmbledhëse e mbështetur në njohuritë e përzgjedhura nga tematika “*Historia, arti dhe shoqëria*” për hartimin e planit të periudhë së III (Prill-Qershor).

Në këtë shembull detyra përmbledhëse është: Konkurs me dy skuadra.

DETYRA PËRMBLEDHËSE – PERIUDHA III (PRILL-QERSHOR)			
	Tematikat e lëndës	Rezultatet e të nxënit	Përqindjet %
I	<i>Historia, arti dhe shoqëria</i>	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - vlerëson veprën e artit në kontekstin kulturor dhe atë historik; - interpreton dhe vlerëson aspektin shprehës dhe simbolik në një vepër ose objekt arti; - identifikon dhe kategorizon veprat e artit sipas teknikës, periudhës, stilit dhe artistit. 	100%
TEMA E DETYRËS: Konkurs me dy skuadra			
Metodologjia e zhvillimit të DP			
II	<p><i>Për zhvillimin e kësaj detyre përmbledhëse mësuesit duhet të realizojnë hapat e mëposhtme.</i></p> <p>Hapi 1:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bëhet ndarja e klasës në dy skuadra. - Diskutohet nga secila skuadër pyetjet që do të drejtojnë lidhur me njohuritë e marra gjatë periudhës. (25 – 38 %) - Secili grup mbledh imazhe dhe foto që do të jenë pjesë e pyetësorit të konkursit. (39-51 %) - Secila skuadër përgatit pyetjet dhe përgjigjet për skuadrën tjetër. (52 -64 %) <p>Hapi 2:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vendosin rregullat e konkurrimit dhe pikët për secilën pyetje. - Hidhet shorti, i cili përcakton se cila nga skuadrat do të fillojë pyetësorin e para. - Gjatë kohës së konkurrimit, një nxënës/e mbledh pikët dhe kur skuadra që nuk i përgjigjet pyetjes ose i përgjigjet asaj pjesërisht, skuadra tjetër, jep përgjigjen dhe argumenton pikët. (65 – 77%) <p>Hapi 3:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Numërohen pikët e mbledhura nga skuadra fituese sipas numrit të pikëve të 		

	mbledhura dhe shpallet skuadra fituese. (78 -90 %)						
	- Çdo skuadër, diskuton duke reflektuar konkluzionet e punës në grup dhe tregon nëse bashkëpunimi e arriti rezultatin, ose jo, duke gjetur arsyet. (91 – 100 %)						
Vlerësimi i DP							
III	N 2	<ul style="list-style-type: none"> - përshkruan veprën e artit në kontekstin kulturor dhe atë historik; - identifikon aspektin shprehës dhe simbolik në një vepër ose objekt arti; - dallon periudhën historike, artistin dhe teknikën artistike në veprat e artit; 					
	N 3	<ul style="list-style-type: none"> - shpjegon veprën e artit në kontekstin kulturor dhe atë historik; - shpjegon dhe interpreton aspektin shprehës dhe simbolik në një vepër ose objekt arti; - identifikon teknikën artistike, periudhën historike dhe artistin në veprat e artit; 					
	N 4	<ul style="list-style-type: none"> - vlerëson veprën e artit në kontekstin kulturor dhe atë historik; - interpreton dhe vlerëson aspektin shprehës dhe simbolik në një vepër ose objekt arti; - identifikon dhe kategorizon veprat e artit sipas teknikës, periudhës historike, stilit dhe artistit. 					
Skema e vlerësimit							
Nota	4	5	6	7	8	9	10
% e pikëve	< 25 %	25 – 38 %	39-51 %	52 -64 %	65 – 77%	78 -90 %	91 – 100 %

Mësuesi: Eni Larushku

KLASA: X -XII-të

SHKOLLA: Skënder Çaçi

QYTETI: Tiranë

LËNDA: Art pamor

Ky shembull i detyrës përmbledhëse, është realizuar duke u mbështetur në njohuritë e përzgjedhura nga tematika e lëndës “Teknika dhe procese artistike”, periudha II (janar –mars).

Në këtë shembull detyra përmbledhëse është: Ekspozitë

DETYRA PËRMBLEDHËSE – PERIUDHA II (JANAR-MARS)			
	Tematikat e lëndës	Rezultatet e të nxënit	Përqindjet %
I	<i>Teknika dhe procese artistike</i>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> demonstron nivel të lartë në përdorimin e teknikave të larmishme artistike gjatë krijimit; demonstron aftësi të lartë në përdorimin e teknikave artistike gjatë realizimit të punimeve si nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra edhe nëpërmjet kujtesës së tij/saj mbi objektet, njerëzit, etj., dhe nëpërmjet imagjinatës; demonstron aftësi në seleksionimin, përgatitjen dhe paraqitjen e punimit; analizon eksperiencat e tij/saj krijuese dhe respekton mendimin e tjetrit. 	100%
TEMA E DETYRËS: Ekspozitë			
Metodologjia e zhvillimit të DP			
II	<p><i>Për zhvillimin e kësaj detyre përmbledhëse mësuesit duhet të realizojnë hapat e mëposhtme.</i></p> <p>Hapi 1:</p> <ul style="list-style-type: none"> Ndarja e nxënësve në katër skuadra, sipas një shorti/lojë, ku secila prej skuadrave përzgjedh punimet që kanë krijuar dhe që do të prezantojë në ekspozitë. Diskutimi i skuadrave me njëra - tjetrën mbi mënyrën e ekspozimit të punëve të përzgjedhura. (25 – 38 %) Krijimi i një mjedisi pozitiv dhe klime miqësore ndërmjet njëri –tjetrit, klimë bashkëpunimi, klimë ndërveprimi si formë e organizimit të një ekspozite të sukseshme. (39-51 %) <p>Hapi 2:</p> <ul style="list-style-type: none"> Diskutimi dhe përcaktimi i hapësirave të tyre për ekspozim. Vendosja e punimeve në tabakë kartoni, diskutimi lidhur me punimet artistike të perzgjedhura sipas tematikës përkatëse. (52 -64 %) Prezantimi i punimeve të realizuara nga çdo skuadër në teknikat e ndryshme artistike, duke shpjeguar karakteristikat e teknikës, mjetet shprehëse të saj dhe temën e përzgjedhur për të realizuar këtë teknikë artistike. (65 – 77%) <p>Hapi 3:</p>		

	<ul style="list-style-type: none"> - Diskutimi mbi punimet e tyre dhe mënyrën e realizimit, duke vlerësuar gjetjen dhe përshtatjen e teknikës për tematikën e përzgjedhur. (78 -90 %) - Shpjegimi i përdorimit të teknikave artistike gjatë realizimit të punimeve psh: nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra, nëpërmjet kujtesës së tij/saj mbi objektet, njerëzit, etj., dhe nëpërmjet imagjinatës. - Vlerësimi duke vendosur dy yje dhe një dëshirë për çdo punim, duke dhënë shpjegimet e vlerësimit. (91 – 100 %) 						
Vlerësimi i DP							
III	N 2	<ul style="list-style-type: none"> - përdor nëpërmjet shembujve ndihmës mundësitë shprehëse të disa teknikave artistike gjatë krijimit; - përdor shembuj ndihmës në përdorimin e teknikave artistike për të realizuar punime nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra apo nëpërmjet kujtesës së tij/saj mbi objektet, njerëzit, etj., dhe nëpërmjet imagjinatës; - përgatit dhe paraqet punimin artistik nëpërmjet hapave ndihmës; - përshkruan eksperiencat e tij/saj krijuese dhe respekton mendimin e tjetrit. 					
	N 3	<ul style="list-style-type: none"> - përdor në mënyrën e duhur mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike gjatë krijimit; - krijon duke demonstruar aftësi në përdorimin e teknikave artistike gjatë realizimit të punimeve si nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra edhe nëpërmjet kujtesës së tij/saj mbi objektet, njerëzit, etj., dhe nëpërmjet imagjinatës; - seleksionon, përgatit dhe paraqet punimin artistik; - shpjegon eksperiencat e tij/saj krijuese dhe respekton mendimin e tjetrit. 					
	N 4	<ul style="list-style-type: none"> - demonstroi nivel të lartë në përdorimin e mundësive shprehëse të teknikave të larmishme artistike gjatë krijimit; - demonstroi aftësi të lartë në përdorimin e teknikave artistike gjatë realizimit të punimeve si nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra edhe nëpërmjet kujtesës së tij/saj mbi objektet, njerëzit, etj., dhe nëpërmjet imagjinatës; - demonstroi aftësinë seleksionimin, përgatitjen dhe paraqitjen e punimit; - analizon eksperiencat e tij/saj krijuese dhe respekton mendimin e tjetrit. 					
Skema e vlerësimit							
Nota	4	5	6	7	8	9	10
% e pikëve	< 25 %	25 – 38 %	39-51 %	52 -64 %	65 – 77%	78 -90 %	91 – 100 %

